

VENDIM
Nr.119, datë 2.2.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.268, DATË 5.3.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR RRËSHEN-KALIMASH (PJESA E TRETË)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3 të vendimit nr.268, datë 5.3.2008 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

- a) Sipërfaqja 58 570 m², tokë/arë bëhet 58 070 (pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëdhjetë) m².
- b) Vlera e kompensimit, për sipërfaqen tokë/arë, nga 38 070 500 (tridhjetë e tetë milionë e shtatëdhjetë mijë e pesëqind) lekë bëhet 37 745 500 (tridhjetë e shtatë milionë e shtatëqind e dyzet e pesë mijë e pesëqind) lekë.
- c) Sipërfaqja 8 859,5 m², tokë/truall bëhet 9 359,5 (nëntë mijë e treqind e pesëdhjetë e nëntë presje pesë) m².
- ç) Vlera e kompensimit, për sipërfaqen tokë/truall, 13 289 250 (trembëdhjetë milionë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë bëhet 14 039 250 (katërmëdhjetë milionë e tridhjetë e nëntë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë.
- d) Vlera e përgjithshme e shpronësimit, nga 51 359 750 (pesëdhjetë e një milionë e treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë bëhet 51 784 750 (pesëdhjetë e një milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë.

2. Pronari të kompensohet për diferencën e konvertimit në truall, të sipërfaqes së shpronësuar, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Totali i diferencës së konvertimit, prej 425 000 (katërqind e njëzet e pesë mijë) lekësh, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

4. Likuidimi të fillojë më 30.1.2009 dhe të përfundojë më 30.3.2009.

5. Pronari i shënuar në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohet për diferencën përkatëse të konvertimit nga tokë/arë në tokë/truall, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarit brenda afateve të përcaktuara në pikën 4 të këtij vendimi, në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

7. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE

LISTA E PRONARËVE QË PREKEN NGA KORRIDORI DURRËS-MORINË (SEKSIONI RRËSHEN-KALIMASH)

Lloji i pasurisë së patundshme: tokë truall

Nr.	Emri	Pronari		ZK	VKM nr.268, datë 5.3.2008					Pronari			ZK	Ndryshimi sipas ZRPP-së					Shënime
		Atësia	Mbiemri		Nr.pas	Sip.shpronësuar	Arë kthyer në truall	Çmimi m ²	Vlera lekë	Emri	Atësia	Mbiemri		Nr.pas	Sip m ² truall	Çmimi m ²	Vlera lekë	Diferenca e llogaritur për likuidim	
	Fshati Sang																		
1	Anton	Preng	Prenga	3259	107	3650	500	650	325 000	Anton	Preng	Prenga	3259	107	500	1500	750 000	425 000	Konfirmuar nga ZRPP
			Totali				500		325000						500		750 000	425 000	

